

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS PËR SIGURIMIN E MALLIT GJATË TRANSPORTIT

1. KUSHTE TE PERGJITHSHME

1.1 “Siguruesi” është shoqëria e Sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a . me adrese Blv. “ZOG I”, Nr.1, Tirane, Person Juridik me Autorizim nr 2, date 29.06.1999 NIPT: J91809007H, Kod fiskal: 3708093.

1.2” Siguruari” është çdo person fizik ose juridik qe e ka emrin te shenuar ne policen e sigurimit, i cili gezon nje interes per mallin qe transportohet.

1.3”Perfituesi” është çdo person fizik ose juridik qe e ka emrin te shenuar ne policen e sigurimit si i tille, i cili emerohet nga i Siguruari dhe ka perparesine ne perfitimin e demshperblimit perpara te Siguruarit, ne vleren e percartuar nga marreveshja mes ketyre paleve.

1.4”Mall” është çdo send apo objekt jo shpirtëror, i konvertueshem ne vlere monetare, te cilin i siguruari ka interes ta siguroje gjate perudhes se transportit.

1.5”Pyetesor” është dokumenti qe ploteson dhe firmos i Siguruari, perben bazen e kontrates midis tij dhe Siguruesit. I Siguruari garanton saktësinë e informacionit te deklaruar ne pyetesor. Nese ndonje pjesë e informacionit është e pavertete apo e padeklaruar, Siguruesi ka te drejte ta ndërprese kete kontrate qe prej fillimit te tij.

1.6”Police Sigurimi” është dokumenti, te cilin e lëshon “Siguruesi” per te regruar qe malli i percartuar ne te, ose ne dokumentin te cilit i referohet Polica, është i mbuluar me sigurim gjate transportit.

1.7”Pjesa e Zbritshme” është pjesa e pagueshme e demit ne ngarkim te te siguruarit, e shprehur ne Policen e Sigurimit ne vlere monetare ose ne perqindje te shumes se sigurimit.

1.8”Shuma e siguruar” është vlera e mallit te mbuluar me sigurim gjate transportit, e percartuar ne Pyetesor nga i Siguruari, qe mund te perfshije edhe fitimin e shpresuar, ne rast se është kerkuar ne Pyetesor.

2. BAZA LIGJORE

2.1 Kodi Civil i Republikes se Shqiperise

2.2 Kodi Detar i Republikes se Shqiperise

2.3 Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise

2.4 Kodi Ajror i Republikes se Shqiperise

2.5 Kushtet e Përgjithshme te Kontrates per Sigurimin e Mallit GjateTransportit, bazuar ne kushtet e “Institute Cargo Clauses” te tregut ndërkombëtar te sigurimeve te Lloyd’s-it ne Londer, qe ketu e me poshte do te quhen shkurtimisht Kushtet e Sigurimit.

3. OBJEKTI I SIGURIMIT

3.1 Siguruesi mbulon me sigurim mallin gjate transportit per Kategorine e mbulimit “A”, qe nenkupton çdo ngjarje aksidentale, te papritur dhe te paparashikuar, me perjashtim te rasteve te percartuara ne piken 6.

3.2 Siguruesi mbulon me sigurim mallin gjate transportit, per Kategorine e mbulimit “B”, me perjashtim te rasteve te percartuara ne piken 6 “Perjashtime” te kontrates, per rreziqet e:

3.2.1 Zjarrit ose shperthimit; 3.2.2 Mallit te demtuar kur anija takon ne cekine ose permbysset; 3.2.3 Mallit te demtuar ne rast permbysjeje apo daljeje nga shinat te mjetit te transportit ne toke; 3.2.4 Mallit te demtuar ne rast perplasjeje apo kontakti te mjetit lundrues apo te mjetit transportues ne toke me nje objekt tjetër te ndryshem nga uji; 3.2.5 Mallit te shkarkuar ne portin e fatkeqesije; 3.2.6 Termeteve, rrufeve dhe vullkanëve; 3.2.7 Hedhjes se detyruar te ngarkeses ne det; 3.2.8 Humbjes totale per çdo pako te rene ne detyr apo ne toke me pasojë dëme, nga bordi i anijes apo mjeti transportues tokesor, gjate ngarkimit apo shkakrimit ne keto mjete.

3.3 Siguruesi mbulon me sigurim mallin gjate transportit, per Kategorine e mbulimit “C” qe nenkupton sigurimin vetem per rreziqet e permendura ne piken 3.2 te pikes 3 te kontrates, duke perjashtuar nga mbulimi ne sigurim pikat 3.2.6 dhe 3.2.8 te pikes 3 dhe perjashtimet e percartuara ne piken 6 te kontrates.

4. SHTRIRJA TERRITORIALE

4.1 Siguruesi mbulon me sigurim mallin kundrejt primit perkates, per transporte tokesor ne te gjithë Europen, per transporte detare dhe per transporte ajrore ne te gjithë globin, me perjashtim te vendeve te sanksionuara nga Kombet e Bashkuara.

5. KOHEZGJATJA

5.1 Mbulimi ne sigurim fillon ne oren 24.00 te dites se percartuar si dite e fillimit ne policen e sigurimit dhe perfundon ne oren 24.00 te dites se percartuar si dite e mbarimit ne Policen e sigurimit me kushtin qe polica e sigurimit do te hyje ne fuqi dhe do te krijojë efekte ligjore vetem pasi te jetë paguar primi perkates i sigurimit.

5.2 Sigurimi i çdo ngarkese malli ne transport fillon nga momenti i levizjes se pjeses se pare te mallit per ne mjetin e transportit dhe perfundon me vendosjen e pjeses se fundit te mallit ne magazinën apo vendin e percartuar ne police, sipas kerkeses se plotësuar nga i Siguruari.

5.3 Sigurimi i çdo ngarkese malli zgjat gjate gjithë levizjes se zakonshme te tranzitit.

5.4 Sigurimi i çdo ngarkese malli perfundon:

5.4.1 Me perfundimin e shkakrimit nga mjeti i transportit sipas pikes 5.1

5.4.2 Me perfundimin e shkakrimit nga mjeti transportues ne nje vend tjetër nga ai i vendosur ne Police.

5.4.3 Me kalimin e 30 diteve nga momenti i levizjes se pjeses se pare te mallit per ne mjetin e transportit.

5.4.4 Me kalimin e 15 diteve nga data e fillimit te sigurimit, e shprehur ne police, per transportet tokesore, 30 dite per transportin detar dhe 7 dite per transportin ajror.

5.4.5 Kur malli ka pushuar se ekzistuari perpara dates se fillimit te sigurimit. Ne kete rast, primi i mundshem i paguar i kthehet te Siguruarit duke ju mbajtur kostot administrative.

5.5 Sigurimi i çdo ngarkese malli do te vazhdoje te jete ne fuqi pavaresisht pikes 5.4 paragrafeve 5.4.3 dhe 5.4.4, nese Siguruesi miraton me shkrim ne baze te njoftimit te menjehershëm per shakaet e justifikuara te kesaj vonese nga ana e te Siguruarit.

6. PERJASHTIME

6.1 Siguruesi, nuk do të dëmshpërblejë, humbjet apo dëmtimet, që pëson pasuria e siguruar, në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekt, jone shkaktuar, rrjedhin ose janë rënduar gjate, në ose nga:

6.1.1 Deme apo shpenzime si pasojë e luftes, luftes civile, revolucionit ose akteve te tjera luftarake te ndërmarrja nga forca te ndryshme me pasojë dëmtimin, dëgjen apo shkatërrimin e mallrave; 6.1.2 Deme apo shpenzime qe vijne si pasojë e nje rrjedhjeje te zakonshme, humbjeje te zakonshme ne peshe dhe volum, konsum dhe amortizim te objektit te siguruar; 6.1.3 Deme apo shpenzime qe vijne si pasojë e pamjaftueshmërise ose papershtatshmërise se paketitmid gjate perqatitjes per transport te objektit te siguruar, kur ky paketim është kryer nga i Siguruari, punonjësit apo agjentët e tij. Ne kuptimin e kesaj pike, me fjalën “paketim” do te kuptohet edhe stivosa e mallit ne kontenier dhe me fjalën “punonjësit” nuk do te pershihin kontraktues te pavarur qe kryejne sherbime per te siguruarin; 6.1.4 Deme apo shpenzime qe vijne si pasojë e vesëve te brendeshme ose te natyres se objektit te siguruar; 6.1.5 Deme apo shpenzime nga ose per vonesa te çfaredo lloji edhe n.q.s. kjo është shkaktuar nga nje rrezik i siguruar; 6.1.6 Deme apo shpenzime qe vijne si pasojë e paafetësie paguese ose te detyrimeve me karakter financiar te pronarëve ose qeramarresëve te tyre, avionëve apo mjeteve te tjere te transportit; 6.1.7 Deme apo shpenzime si pasojë e perdorimit te cdo lloj armatimi luftarak qe mbeshtetet dhe/ose shfrytëzton reaksionet atomike dhe nukleare, shperthimin berthamor ose reaksione te tjera te ngjashme dhe/ose lendet radioaktive; 6.1.8 Deme apo shpenzime qe vijne si pasojë e pavlefshmërise se anijes ose mjetit te transportit, papershtatshmërise se anijes, kontenierit, ose vëndit shkarakes apo ngarkues dhe rrethanave te tjera qe kane te bejne me kushtet specifike te ngarkimit, shkakrimit ose transportimit te mallrave, perfshire edhe rastin kur i Siguruari nuk kishite dëjeni per keto; 6.1.9 Deme apo shpenzime si pasojë e nje veprimi apo mosveprimi te paramenduar i te siguruarit ose dëme apo shpenzime si pasojë e akteve keqdashese te personave te trette . Me “akte keqdashese” do te kuptojme dëmet e ndodhura ne pasurine e siguruar nga veprime te kryera me vullnet te plote ne menyre te qellimshme apo keqdashese nga pale te treta pa miratimin, dëjfinen dhe/ose pelqimin e te siguruarit. 6.1.10 Deme apo shpenzime qe vijne si pasojë e kapjes, mbajtjes peng (perjashtuar piraterine), arrestimit, kufizimit ose pengimit si dhe cdo pasojë ose perpelkje qe lind nga kjo; 6.1.11 Deme apo shpenzime qe vijne si pasojë e shperthimit te minave, silurave, bombave ose armeve te tjera luftarake te lena nga lufta; 6.1.12 Deme apo shpenzime si pasojë e punetoreve qe kane ndërperre punen ose nga personat qe marrin pjesë ne trazirat e punes, turbullirat ose trazirat civile; 6.1.13 Shpenzime si pasojë e grevave, ndërprerjeve te punes, trazirave ose turbullirave civile; 6.1.14 Deme apo shpenzime nga çfaredo lloj akti terrorist, i ndërmarrë nga kushdo qe vepron ne emer te/ ose ne lidhje me çdo grupim apo organizate, qe kryen veprime te drejtpërdrejta apo influencën nepërmjet forceve apo dhunes, per permbysjen e çdo qeverie, qoftë kjo e njohur apo jo ligjeshit; 6.1.15 Deme apo shpenzime si pasojë e akteve te çdokujt qe vepron nga motive politike, ideologjike apo fetare;

6.2 Perjashtohen gjithashtu nga ky mbulim ne sigurim dëmtimet ne sende te tilla si monedha, objekte te gërmeshme, bagazhe, valixhe, duhani apo substanca psikotrope, si dhe letra me vlerë. Per marrjen ne sigurim te sa me sipër, i Siguruari dhe Siguruesi mund te nënshkruajne nje kontrate te veçantë.

6.3 Siguruesi nuk mbulon me sigurim dëme apo shpenzime qe rrjedhin nga çdo perqjegjesi e vendosur sipas nje kontrate tjetër.

6.4 Siguruesi nuk do te paguaje kerkesa per demshperblim per çdo gjobe apo dënim, as per çdo perqjegjesi mbi mallin, per dëme apo shpenzime qe rrjedhin nga veprime apo mosveprime te te siguruarit ne kundërshti me legjislacionin shqiptar, ndërkombëtar apo te shtetit ku ndodh ngjarja.

7. DETYRIMET E TE SIGURUARIT

7.1. Është detyrë e te siguruarit qe te veproje sipas parimeve te pergjithshme te tregëties. Është detyrë e te Siguruarit qe te siguroje se te gjitha transportet qe kryhen nga ai do te jene te konfirmueshme nga ana ligjore nepërmjet kontratave te transportit apo marreveshje te tjera te ngjashme ta io.

7.2. I Siguruari duhet t’i njoftoje siguruesit, me rastin e lidhjes se kontrates, te gjitha rrethanat per te cilat ka dëjeni dhe qe kane rendesi thelbësore per përcaktimin e natyres dhe se mases se rrezikut. Quket se kane rendesi thelbësore te gjitha rrethanat e nje natyre te tille qe mund te influencojne vendimin e siguruesit per marrjen ose jo ne sigurim apo per kushtet qe duhet te vendose ne kontraten e sigurimit te cilat siguresi i percarton ne pyetesorin per Sigurimin e Mallit gjate Transportit. Shoqëria e sigurimit cëlohet nga detyrimi per demshperblim ne rast se vetëtohet se i siguruari nuk ka dhene informacionin e kerkuar ose ka dhene infomata jo te vërteta ose te pasakta.

7.3. Kur pas lidhjes se kontrates se sigurimit del se i siguruari duke ditur ka dhene infomata jo te sakta ne kerkesen ose ne dokumentin e paraqitura prej tij ne baze te te cilave është lidhur kontrata e sigurimit, siguruesit i lind e drejta te ndryshoje masen e primit te sigurimit, te shumes se sigurimit ose afatin e sigurimit si dhe te zgjidhe kontraten e sigurimit. Primi i sigurimit nuk i kthehet te siguruarit. Ne kete rast ne rast se ndodh ngjarja e sigurimit, siguresi është i dënuar nga detyrimi per demshperblim.

7.4. I Siguruari gjate kohes qe kontrata e sigurimit është ne fuqi detyrohet t’i njoftoje siguruesit te gjitha ndryshimet e rrethanave per te cilat ka marre dëjeni pas lidhjes se kontrates se sigurimit dhe qe mund te influencojë mbi shëtimin e rrezikut, siguresi ka te drejte, qe nga casti i shëtimit te rrezikut, te ndryshoje masen e primit te sigurimit, te shumes se sigurimit, afatin e sigurimit ose te zgjidhe kontraten. Ne qoftë se i siguruari nuk e ben njoftimin e mesiperm, siguresi nuk është i detyruar te paguaje shumen e sigurimit.

8. KERKESA PER DEMSHPERBLIM, PROCEDURAT NE RAST DEMI, DEMSHPERBLIMI

8.1 Nese nje ngjarje ben te lindre nje kerkese per demshperblim sipas çdo Seksioni te kesaj kontrate, i Siguruari duhet te njoftoje sa me shpejt te jete e arsyeshme Siguruesin dhe gjithsesi jo me vonë se 24 ore nga momenti i ndodhjes se ngjarjes me leter rekomande ose me fax. Ne rast tejkalimi te ketij afati, Siguruesi gezon te drejten te cëlohet nga detyrimi i demshperblimit.

8.2 Ne rast vëdjehje apo akti keqdashës, i Siguruari duhet te njoftoje brenda 24 oreve nga ndodhja e ngjarjes, policine lokale dhe autoritetet perkatese sa me shpejt te jete e mundur.

8.3 I Siguruari duhet te marre te gjitha hapat e arsyeshme per te ndaluar apo per te minimizuar çdo humbje qe do te ishte e demshperlyeshme sipas kushteve te ketij sigurimi dhe te minimizojë perqjegjesine ndaj paleve te treta. Shpenzimet per ndalimin apo minimizim e humbjeve jane ne ngarkim te Siguruesit.

8.4 Siguruesi duhet te bashkëpunojë plotësisht me Siguruesin per te siguruar informacionin dhe dëshmite e duhura dhe duhet te lejojë Siguruesin qe te procedojë ne emer te tij (por me shpenzimet e Siguruesit) per te fituar demshperblim nga ndonje pale e trette ne lidhje me mbulimit sipas ketij sigurimi.

8.5 Nese i Siguruari ben nje kerkese per demshperblim, apo deklaratë qe ka lidhje me demshperblimin, per te cilen Siguruesi vetëton qe është fallico apo mashtruese, apo kur i Siguruari nuk furnizon me informacion ne lidhje me nje kerkese per demshperblim, ky siguracion do te behet i pavlefshëm qe prej fillimit te tij dhe do te mbahet i gjithë primi i paguar.

8.6 Kerkesa per demshperblim plotësohet ne nje formular, nje kopje te se cilit mund te gëjendet ne format elektronik ne faqen zyrtare te internetit ose prane zyrate te Siguruesit.

8.7 I Siguruari duhet t’i dorëztojë Siguruesit brenda 3 diteve nga ndodhja e ngjarjes nje liste te firmosur te te gjitha mallrave te demtuara apo shkaktruara sipas formularit te dhene nga Siguruesi. Ne momentin e paraqitjes se kerkeses per demshperblim duhet t’i bashkangjitet dokumentacioni i nevojshëm per te bere te mundur shqyrtimin e rastit te demit: a. Originali i Polices se Sigurimit; b. Originali i Police Ngarkeses; c. Originali i Raportit te Survejmit te leshuar nga personi i autorizuar; d. fatura e shpenzimeve te kryera ne menyre te arsyeshme per te zgjedhur dëmin; e. Fatura origjinale e mallit se bashku me listen korresponduese te paketit; f. Bill of Lading ne kopje origjinale, g. Kontrata me transportuesin ne kopje origjinale; h. Njoftimi i bere ne organet perkatese ne rast vëdjehje; i. Vertetimi i njoftimit te siguruesit brenda 24 oreve nga ndodhja e ngjarjes; j. Foto te objektive dhe mallit te demtuar ose shkatërruar; k. Ne rast dëmtimi te mallit gjate transportit detar letra e protestes nga Kapiteneria e Portit; l. Ne rast dëmtimi te mallit gjate transportit rrugor, dokumentacioni i mbajtur nga organet e policise rrugore. Mos plotësimi i kerkësave te percartuara ne piken 8.7, nenkupton se siguresi nuk është i detyruar te paguaje dëmin e shkaktuar.

8.8 Kerkesa per demshperblim do te quhet e paguar vetëm pasi te jete bere riparimi, zëvendësimi apo rimbursimi dhe i Siguruari ka bere deklaratën e pranimit te vlerës.

8.9 Çdo njoftim, i Siguruarit duhet ta jape te Siguresi ne adresen zyrtare te shenuar ne Police.

8.10 Siguruesi bie dakort (ne varesi te kushteve , peraktëtimeve, perjashtimeve dhe parashikimeve te kesaj police te sigurimit) se nese gjate perudhes te sigurimit ndodh ngjarja e sigurimit e pershkruar ne policen e sigurimit dhe/ose pyetesor qe nenkupton dëmtohet ose shkatërohet nga ndonje prej rreziqeve te percartuara ne policen e sigurimit, atehere siguresi do ti paguaje policembajtesit/ te siguruarit perfitimin e pagueshëm qe do te jete shuma e demit fizik ne pasurine e siguruar ne kohen e demtitit ose shkatërrimit ose ne varesi te zgjedhjes te siguresit te beje rivendosjen ose zëvendësimin e pasurisë te demtuar ose te nje pjesë te saj.

Siguresi, në varesi të dëmit, ka te drejten te vendose pa miratimin e te siguruarit, per përcaktimin e formës te dëmshperblimit ne njerën nga mënyrat si mëposhtë: a. Te kryejë zëvendësim e pjesshem apo te plote te pasurisë te demtuar ose; b. Te kryejë riparim e pasurisë te dëmtuar, me mjetet dhe subjektet e ofruara nga Siguruesi ose; c. Te kryejë pagesën e vlerës së dëmit.

8.11 Demshperblimi do te jete deri ne vleren e demit te ndodhur dhe ne asnjë rast demshperblimi nuk mund te tejkalojë limitin maksimal te perqjegjesise te percartuar ne policen e sigurimit/pyetesorin.

9. AFATET E TRAJTIMIT TE KERKESË PER DEMSHPERBLIM

Siguruesi trajton kerkesen per demshperblim dhe njofton per masen e demshperblimit apo per refuzimin e kerkeses per demshperblim:

9.1 Brenda 30 diteve kalendarike nga data e marrjes se kerkeses per demshperblim dhe plotësimit te dokumentacionit te kerkuar nga Siguruesi;

9.2 Per dëme te mallit, ku shkalla e dëmtimit vlerësohet deri ne 100,000 Leke, afati i trajtimit per demshperblim është brenda 14 diteve nga data e marrjes se kerkeses per demshperblim;

10. PJESA E ZBITRISHME

Ne rastet e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit do te aplikohet pjesë e zbritshme dhe/ose franshiza. Per cdo rast demi, Siguruesi do te zbrese nga shuma totale e demshperblimit pjesen e zbritshme te percartuar ne Policen e Sigurimit ne shume absolute ose ne perqindje. Siguresi nuk do te paguaje per dëme te vecanta qe jane nen shumen e percartuar si franshize ne Policen e Sigurimit.

11. SHUMA E SIGURUAR

11.1 Detyrimi i shoqërise se sigurimit per kompensimin e dëmeve, është i barabartë me shumen e siguruar sipas pyetesorit te plotësuar nga i Siguruari, te vlefshme ne ditën e ngjarjes se sigurimit .

11.2 Pjesa e zbritshme mund te ulet me kerkesen e te siguruarit dhe duke paguar primin perkates shtese.

12. PRIMI I SIGURIMIT DHE HYRJA NE FUQI E POLICES

12.1 Primi i Sigurimit është i percartuar sipas tabelave te miratuara nga Siguruesi, ne varesi te shumes se siguruar, vlerësimit te rrezikut, vendit te njësës dhe mberritjes, si dhe politikave qe ndëk Siguruesi.

12.2 Primi i Sigurimit duhet te paguhet perpara dates kur hyn ne fuqi Polica e Sigurimit sipas përcaktimit ne Police sipas kerkeses se te Siguruarit.

12.3 Ne rast mospagimi te Primit te Sigurimit, Polica e Sigurimit pezullohet automatikisht dhe nuk krijon efekte juridike per siguresin deri ne oren 24:00 te dites qe paguhet primi i sigurimit.

13. ZGJIDHJA DHE LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM.

13.1 Polica e sigurimit ne kushtet e pikës 12.3 do te vazhdoje te qëndrojë e pezulluar per periudhen kohore te parashikuar ne piken 5.3 dhe zgjidhet automatikisht ne perfundim te kesaj periudhe kohore. I Siguruari është i detyruar te paguaje Siguruesin per kostot administrative.

13.2 Çdo ndryshim i mundshëm i kushteve te kontrates duhet te miratohet me shkrim nga i Siguruari dhe Siguruesi.

13.3 Kjo kontrate mund te zgjidhet ne te dyja palet duke dhene njoftim me shkrim te paktën 7 dite perpara dates se fillimit te sigurimit. Kjo kontrate sigurimi rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

13.4 Per cdo mosmarreveshje te lindur ndërmjet paleve, kompetente per zgjidhjen e çështjes është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE

Pavarësisht dispozitave tjera të kesaj kontrate, kjo kontratë sigurimi ofron mbulim për aq sa mbulimi me sigurim nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kesaj kontrate. Kjo klauzolë gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.”

MBROJTJA E TE DHENAVE PERSONALE

I siguruari është njohur me deklaratën e privatesisë të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënieën e sherbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit përshëri trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo sherbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”) si dhe transferimin e të dhënave personale te te tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Ne cdo rast, mbrojtja e të dhënave personale do të behet ne perputhje me rregullat dhe procedurat e percartuara te Ligj Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

E DREJTA E INFORMIMIT

I siguruari ka te drejten te informohet nga Siguruesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose perfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjate perudhës se levizshmërisë së kontratës. Informimi merret nepërmjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare ne internet apo borshurave informative te perdorura nga shoqëria.

I siguruari dhe/ose Policëmbajtes i jane informuar nga Siguruesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marre te gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me te dhenat juridike te siguresit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit te kerkësave per demshperblim, rreziqet e mbuluar dhe te perjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe menyra e pageses se primit, metodën e llogaritjes se vlerës se kompesueshme dhe cdo informacion tjetër qe ka lidhje me kontraten e sigurimit.

E DREJTA E TE SIGURUARIT PER TU ANKUAR

I siguruari apo persona të tjerë të interesuar, kane te drejte të paraqesin një ankësë pranë shoqërisë së sigurimit, ne rast se cmojne se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund te paraqitet ne forme elektronike (e-mail) ose me shkrim ne adresen postare te shoqërisë. Shoqëria e sigurimit do ti pergjigjet cdo ankese të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do te jap çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve te percartuara ne ligj.

Çdo mosmarreveshje ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate është ne varesi ekskluzive e juridiksionit te Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tirane dhe i zbatueshëm është Legjislacioni Shqiptar.

Nënshkrimet e paleve ne policen e sigurimit vetëtojnë se kane rene dakort me informacionin e dhene paraqishtë, kane lexuar dhe kuptuar te gjitha termat dhe kushtet e kesaj kontrate sigurimi, dhe pranojne me vullnet te lire t'i respektojne zbatojne ato. keto kushte jane njohur dhe pranuar per tu respektuar dhe zbatuar nga perfituesi i kesaj kontrate i cili është dhe mbajtes i kontrates.